



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Mitrovicës së Jugut
Opština Južna Mitrovica – Municipality of Mitrovica South

KUVENDI I KOMUNËS SË MITROVICËS SË JUGUT
Nr. 02-060/01- 0005630-17/26, dt. 10.02.2026
Mitrovicë

02-060/01-0005630-17/26

10.02.2026

Në zbatim të nenit 12, paragrafi 2, alineja d, nenit 25, të Ligjit Nr. 03/L-040 Për vetëqeverisjen lokale (GZ Nr. 28, publikuar më 4 qershor 2008); nenit 5, paragrafi 2, të Ligjit Nr. 03/L-087 Për ndërmarrjet publike; nenit 13, paragrafi 1, nënparagrafi 1.4, dhe 46 paragrafi 1, nënparagrafi 1.5, të Statutit të Komunës, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e rregullt të mbajtur më dt. 10.02.2026, sjell këtë:

VENDIM

Për formimin e Komisionit Komunal të Aksionarëve të N.P. "Tregu"

1. Me këtë vendim FORMOHET Komisioni Komunal të Aksionarëve të N.P. "Tregu", në përbërje:
 1. Shkëlqim Ibrahim, i
 2. Elfate Ademi Bahtiri, dhe
 3. Nazmi Kelmendi (i emëruar nga Kryetari i Komunës).
2. Komisioni Komunal i Aksionarëve vepron në emër të Komunës dhe duhet të veprojë në përputhje me Ligjin për ndërmarrjet publike dhe Ligjin për shoqëritë tregtare.
3. Komisioni me shumicë të thjeshtë votash vendos se si do t'i ushtrojë të drejtat e aksionarit të komunës në një çështje të caktuar.
4. Komisioni do të përgatisë dhe nxjerrë një politikë të pronësisë e cila i paraqet objektivat e përgjithshme të Komunës në lidhje me pronësinë dhe rolin e saj në qeverisjen e N.P. "Tregu". Kjo politikë e pronësisë duhet të jetë në përputhje me dispozitat e Ligjit për ndërmarrjet publike dhe dispozitat tjera të aplikueshme ligjore në Kosovë. Kjo politikë e pronësisë po ashtu duhet të përmbajë dispozita të hollësishme mbi mënyrën e zbatimit të saj.
5. Komisioni Komunal i Aksionarëve i përgjigjet Kuvendit të Komunës mbi mënyrën e ushtrimit të kompetencave dhe përgjegjësi të cilat u janë dhënë me ligj dhe do t'i raportojë Kuvendit të Komunës në bazë vjetore mbi performancën e këtyre kompetencave dhe përgjegjësi, si dhe mbi arritjen e objektivave të përcaktuara në politikën e pronësisë, si dhe do t'i sigurojë të dhëna kuantitative dhe të qëndrueshme publikut dhe Kuvendit të Komunës mbi mënyrën e menaxhimit të ndërmarrjes.
6. Komisioni i përgjigjet Kuvendit të Komunës mbi mënyrën e ushtrimit të kompetencave dhe përgjegjësi të cilat u janë dhënë me këtë ligj.
7. Vendimi shpallet tridhjetë (30) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë përgjegjëse për Vetëqeverisje Lokale dhe hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në gjuhët zyrtare në ueb faqen e Komunës së Mitrovicës së Jugut.

Mitrovicë

Kryesuesi i Kuvendit

Safet KAMBERI

Dorëzohet:

- 1 x 1 Kryesuesit të Kuvendit
- 1 x 1 MAPL-së
- 1 x 1 Arkivit
- Kopje: Kryetarit të Komunës
- Anëtarëve të Komisionit